



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.50/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. **PRANOHET** e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.50/2025 e datës 16.01.2025.
- II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 16.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më 16 janar 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje, në Skenderaj ka identifikuar posterin e vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rr. "Pazari i Vjetër", të kandidatit për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës - PDK, Mërgim Lushtaku.

Tutje në ankesë theksohet se me këtë veprim PDK, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore.

Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, parashtuesi i ankesës kërkon që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e posterit në kundërshtim me LZP.

Më datë 17.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 18.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 18.01.2025, Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), duke theksuar se kandidati për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës – (PDK), Mërgim Lushtaku, ka marr pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese të qiradhënësit N.SH "Foto Kabashi" dhe në këtë mënyrë ka respektuar në tersi dispozitat e nenit 34 të LZP-së, dhe Rregullores Zgjedhore Nr. 7/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Në Përgjigje Ankesës Subjekti Politik PDK, ka bashkangjitur Kontratën për Hapësira Reklamuese (Bilbord & City Light), mbi shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës reklamuese, e lidhur më datë 03.01.2025 deri më 11.02.2025.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik PDK, ka vendosur posterin e kandidatit për deputete nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës PDK, Mërgim Lushtaku në hapësirat publike, konkretisht në rrugën "Pazari i Vjetër", dhe më të njëjtin veprim subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, PDK, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "1. *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Paneli ka vlerësuar kontratën e bashkangjitur nga subjekti politik PDK, e lidhur me datë 03.01.2025, në mes të palëve si qiradhënës N.SH "Foto Kabashi", me seli në Skenderaj, dhe qiramarrësi Mërgim Lushtaku me vendbanim në Prishtinë, mirëpo të njëjtën nuk ka mundur ta merr për bazë me rastin e vendosjes për këtë çështje, kjo pasi që Kontrata nuk përmban numër të protokollit dhe datë kur është protokolluar, dhe gjithashtu nuk mund të vërtetohet fakti se qiradhënësi N.SH "Foto Kabashi" ka të drejtë të shfrytëzoj këto hapësira publike për dhënie në shfrytëzim dhe reklamim të materialit zgjedhor, ngase nuk i ka bashkangjitur asnjë provë përgjigjes në ankesë, me të cilën do të vërtetohet fakti se të njëjtat hapësira i ka marrë në shfrytëzim nga Komuna e Skenderajt, përkatësisht ka leje për ta bërë një gjë te tillë.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20, 000.00)euro.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.50/2025 më datën 19.01.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.